



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth & Sports

Nr. 30/2015
Datë: 03.03.2015

Ministri i Kulturës Rinise dhe Sportit z. Kujtim Shala, në mbështetje të nenit 145 (pika 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4,21 dhe 22 të Ligjit Nr. 03/L-189, për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 7(shtatë) të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), duke u mbështetur në Nenin 33,38 të Ligjit Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës si dhe duke marrë për bazë Nenin 12 dhe 14 të Statutit të Galerisë Kombëtare të Kosovës, më datën 03.03.2015, mori këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Këshilli Drejtues i Galerisë Kombëtare të Kosovës.
2. Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë, si në vijim:
 - 2.1. Esat Valla
 - 2.2. Nexhat Krasniqi-Nekra
 - 2.3. Ismet Jonuzi
 - 2.4. Afrim Spahiu
 - 2.5. Adriana Sedaj
 - 2.6. Luan Shllaku
 - 2.7. Kimete Berisha, përfaqësuese e MKRS-së.
3. Mandati i Këshillit Drejtues është 4 (katër) vjeçar dhe për punën e tyre kompensohen financiarisht.
4. Kompensimi lejohet në vlerë prej 125.00 (njëqind e njëzet e pesë) euro për Kryetarin e Këshillit Drejtues, ndërsa 100.00 (njëqind) euro për anëtarët e Këshillit Drejtues për secilën mbledhje.
5. Kompensimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues lejohet më së shumti për dy mbledhje të mbajtura gjatë muajit.

6. Këshilli Drejtues e kryen funksionin e tij duke u mbështetur në detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës dhe në Statutin e Galerisë Kombëtare të Kosovës.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kujtim Shala,
Ministër



Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtarëve të emëruar;
- Departamentit të Kulturës;
- Galerisë Kombëtare të Kosovës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së.